

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Krimeve të Rënda** gjyqtari Nikollë Komani, kryetar i trupit gjykues, Besarta Doli dhe Myfera Hoxha, anëtare të trupit gjykues, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale kundër të akuzuarit H. H. nga R., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK- së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP/I. nr. 221/2014, të datës 06.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimeve gjyqësore më datë 07.12.2015, 14.01.2016, 05.02.2016, 29.06.2016, 28.09.2016, 30.09.2016 në prezencën e Prokurorit Agron Matjani, përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës B. B., të akuzuarit H. H. dhe mbrojtësit të tij M. B., avokat në Rahovec më datë **04.10.2016**, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **H. H.**, i biri i A. dhe D., e gjinisë H., i lindur më datë ..., në fshatin R. K. R., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, i martuar, atë i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë në masën e arrestit shtëpiak nga data 24.09.2014 e deri me datë 23.10.2014.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse** në periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2010 e gjerë me datë 22.04.2014, në Rahovec, duke qenë në pozitën e personit zyrtar për paga dhe pagesa në Kuvendin Komunal të Rahovecit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka keqpërdorur pozitën zyrtare, në atë mënyrë që për periudhën e lartë cekur kohore ka futur në faturat e pagesave të rrymës të shpenzuesve të energjisë elektrike, pagesa e të cilave shpenzime bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit dhe atë njehsorin e energjisë elektrike me numër 80004660 në emër të shfrytëzuesit privat G. G. nga Rahoveci dhe atë shumën prej 1.394,35 €, si dhe njehsorin e energjisë elektrike me numër 80016146 në emër të shfrytëzuesit privat N. H. nga Rahoveci në shumën prej 977,55 € ashtu që me këto veprime të kundërligjshme ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Rahovecit në shumë të përgjithshme prej 2.371,90 €.

- **me çka ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.**

**Gjykata në bazë të nenit 6, 17, 41, 43, 45, 73, 74, 422 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së, e :**

**G J Y K O N**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 24.09.2014 e deri me datë 23.10.2014.

Detyrohet i akuzuari që të dëmtuarës Komuna Rahovec të ja kompensoi dëmin e shkaktuar në shumën prej 2.371,90 €, në afatin prej 1 (një) muaj nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej **163,52 €**, dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej **100,00 €**, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda me Aktakuzën PP/I. nr. 221/2014 të datës 06.03.2015, ka akuzuar H. H. nga Rahoveci për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK- së.

Prokurori **Agron Matjani** në fjalën e tij përfundimtare ka theksuar se ngel në tërësi pranë aktakuzës të ngritur kundër të akuzuarit H. H. nga fshati R., Komuna Rahovec, i cili akuzohet për shkak të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit nga neni 422 par. 1 të KPRK-së. Ka shtuar se sa i përket gjendjes faktike është vërtetuar se i akuzuari H. H. në cilësinë e personit zyrtar për pagesa dhe shpenzime pranë Kuvendit Komunal në Rahovec, ka keqpërdorë pozitën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Komunës së Rahovecit, ashtu që me mjetet financiare të Komunës së Rahovecit e ka paguar energjinë elektrike për dy njehsorët elektrik me numër 80004660, i cili ka qenë në emër të shpenzuesit të rrymës G. G. nga Rahoveci, dhe në orën elektrike me numër 80016146 në emër të shpenzuesit të rrymës N. H. nga Rahoveci, ashtu që për G. G. ka paguar shumën 1394,35 €, ndërsa për shpenzuesin N. H. ka paguar shumën 977,55 € dhe se shuma e përgjithshme që është paguar për këto dy orë është 2371,90 €, me të cilën shumë është dëmtuar buxheti i Komunës së Rahovecit. Ka theksuar se i akuzuari H. H. nuk ka pranuar se ka bërë këto pagesa në emër të këtyre dy orëve elektrike, duke u mbrojtur se i njëjti nuk ka banuar në këto banesa por edhe vet ka pranuar se banesën e cila gjendet në rr. "Xhelal Hajda-Toni" në Rahovec, e ka blerë nga një qytetar i quajtur B. F. dhe pretendimin e të akuzuarit se nuk ka ditur se kush ka banuar në këtë banesë, e demantojnë dëshmitarët N. H., G. G. dhe L. S.. Ka shtuar se dëshmitari N. H. ka deklaruar se vet ka banuar në këtë banesë, pasi që ka qenë invalid i luftës dhe në këtë banesë ka banuar 5 (pesë) vite, derisa Kuvendi Komunal në Rahovec ja ka ndërtuar shtëpinë, dhe rrymën asnjë herë nuk e ka paguar, por faturat të cilat kanë ardhur nga KEK-u, ai është lajmëruar në KEK-ë dhe ju ka thënë se nuk ka para për të paguar pasi është invalid i luftës, dhe ata asnjëherë nuk e kanë detyruar që të paguaj, e po ashtu ka theksuar se para se të largohet nga kjo banesë, ka dëgjuar se këtë banesë e ka blerë i akuzuari H. H.. Ka theksuar se po ashtu edhe dëshmitari L. S., ka dëshmuar se lidhur me pagesën e rrymës elektrike nga ana e Kuvendit Komunal ka marrë një informatë se Kuvendi i Komunës është duke paguar dy orë private për shpenzimet e rrymës dhe menjëherë në vitin 2014, ka ndërmarrë veprimet për të zbuluar se cilët njehsor elektrik privat është duke i paguar Kuvendi i Komunës në Rahovec dhe pas intervenimit në KEDS, janë siguruar orët e rrymës dhe emrat e shfrytëzuesve privat ku ka qenë fjala për orën elektrike të N. H. dhe G. G., të cilat i ka pasur në shfrytëzim i akuzuari H. H. dhe ndaj tij janë ndërmarrë procedura të parapara me ligj, e po ashtu edhe dëshmitari G. G. në deklaratën e tij ka deklaruar se ka jetuar në banesë ku afër tij ka qenë banues edhe i akuzuari H. H.. Ka shtuar se lidhur me pagesat që janë bërë nga ana e Kuvendit për këta dy njehsor të lartë cekur është angazhuar eksperti financiar A. Sh. i cili ka jap

mendimin dhe konstatimin e tij në formë të shkruar të datës 20.02.2015, po ashtu edhe e ka plotësuar këtë mendim pa ndonjë ndryshim thelbësor dhe se i njëjti ka konstatuar se Komuna e Rahovecit ka pësuar dëm në lartësi prej 2371,90 €, për këta dy njehsor dhe për njehsorin e parë shuma ka qenë 1394,35 €, dhe për njehsorin e dytë shuma ka qenë 977,55 €. Ka shtuar se nga këto prova është vërtetuar pa mëdyshje se i akuzuari H. H. me mjetet financiare–paratë e Kuvendit Komunal në Rahoveci i ka paguar shpenzimet e rrymës elektrike dhe atë për banesën të cilën e ka blerë vet dhe për banesën tjetër ku ka banuar me qira, andaj nuk ka pasur askush tjetër prej personave zyrtar që këto mjete ti keqpërdorë dhe të derdhen në faturat e shpenzimeve të rrymës elektrike që kanë qenë banesat në të cilat i ka blerë dhe i ka shfrytëzuar H. H., andaj propozon që trupi gjykues të akuzuarin ta shpall fajtor për shkak të veprës penale për të cilën akuzohet dhe ti shqiptoi një dënim sipas ligjit, mirëpo gjatë caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit të merren parasysh rrethana lehtësuese që qëndrojnë në anën e të akuzuarit dhe atë është hera e parë që paraqitet para organeve të drejtësisë, është njeri familjar, është i sëmur dhe faktin se i njëjti nuk punon në të njëjtin vend të punës, por punon në vendin e punës referent për pranimin e ankesave të qytetarëve, e po ashtu propozon që i akuzuari të obligohet që ti paguaj shpenzimet gjyqësore dhe paushallit gjyqësor.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar **B. B.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se sa i përket ndjekjes penale e kanë lënë në kompetencë të prokurorit, ndërsa sa i për ketë kompensimit dëmit nëse i akuzuari shpallet fajtor kërkojnë kompensim dëmi.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. H., avokati **M. B.** në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë, i akuzuari H. H. është akuzuari për shkak të veprës penale të përshkruar më lartë dhe pas zhvillimit të shqyrtimeve kryesore dhe shqyrtimit të fundit gjyqësor më 28.09.2016, i akuzuari që në fillim është deklaruar i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar. Ka shtuar se nga përshkrimi i dispozitivit të aktakuzës është cekur se kinse i akuzuari në periudhën e cekur në akuzë, ka futur në faturat e pagesave të rrymës të shpenzuesve të energjisë elektrike, pagesa të bërë nga buxheti i Komunës së Rahovecit, si person zyrtar dhe atë në emër të njehsorit të energjisë elektrike me numra dhe në emër të përshkruara si në dispozitivit të aktakuzës duke e dëmtuar buxhetin e Komunës së Rahovecit në shumë të përgjithshme prej 2.371,90 €. Ka theksuar se nga mbrojtja e të akuzuarit si dhe provave tjera të përcaktuara është vërtetuar se i akuzuari nga ana e Kryetarit të Komunës si zyrtar i shpenzimeve është caktuar që në fillim të vitit 2009, përndryshe punët dhe detyrat e punës të zyrtarit të shpenzimeve i janë caktuar si punë shtesë, pasi që punën bazë e kishte punën e zyrtarit të pagave, e sipas Udhëzimit Administrativ numër 02/2009, gjegjësisht me nenin 8 të këtij udhëzimi përcaktohen detyrat dhe përgjegjësit të zyrtarit të shpenzimeve, e të cilat janë që pas pranimit të faturave të operatorëve mbi pagesën e borxheve i akuzuari si zyrtar i shpenzimeve ishte i obliguar që ti plotësoj urdhrat obliguese për pagesë, ndër to edhe faturat për pagesën e shfrytëzimit të rrymës elektrike nga njehsorët që i ka shfrytëzuar Komuna dhe pas plotësimit të urdhër obligimeve dhe listës së regjistrimit për njehsorët e rrymës elektrike kuptohet sipas faturave të njëjtat i janë dorëzuar zyrtarit autorizues i cili lejon mjetet për pagesë, pas dhënies së lejes nga autorizuesi, kuptohet me listën e cekur dhe atë listën të nënshkruar në fund nga zyrtari i shpenzimeve këtu i akuzuari, dokumentacionin i dorëzohet tek zyrtari zotues i cili ndaj alokon mjete disponuese për pagesë. Ka shtuar se zyrtari zotues faturat-urdhër obligimet dhe regjistrin-listën e shpenzuesve të njehsorëve dhe lejen për pagesë i dërgon tek zyrtari shpenzues, vërtetohet se a janë ndarë mjetet për pagesat e caktuara sipas urdhër

obligimit, i tërë dokumentacioni i dërgohet zyrtarit aprovues apo certifikues dhe në fund zyrtari certifikues i kontrollon komplet dokumentacionin dhe pas kontrollit pasi janë bërë pagesat, e dërgon në arkivën e thesarit të Kuvendit Komunal, të cilin material e nënshkruan dhe i njëjti arkivohet. Ka shtuar se nga mbrojtja e të akuzuarit dhe provave të proceduara të pakontestueshme materiale rezulton se i akuzuari në tërësi ka vepruar sipas detyrave dhe përgjegjësive të përshkruara me vendim dhe udhëzimin administrativ, pasi nga regjistrat-listat e operatorëve sidomos lista e KEDS-it, i ka përpiluar në bazë të faturave të njëjtën listë me nënshkrimin personal kuptohet pas pranimit të faturave, i ka plotësuar urdhrat obliguese për pagesë e pastaj ja ka dorëzuar zyrtarit autorizues, në vazhdimësi janë ndërmarrë edhe veprime të përshkruara më parë dhe i cili dokumentacion është arkivuar në arkivën e Komunës së Rahovecit me të gjitha listat e borxheve. Ka theksuar se kush nga shërbimi dorëzues apo përfaqësuesit e KEDS-it, i kanë dorëzuar apo i kanë marr listat për pagesë, i akuzuari nuk ishte i njoftuar e as që ishte në kompetencë të tij që të përcjell rrjedhën e procedurës së mëtejme, e kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga ekspertiza financiare A. Sh. të dhënë në ekspertizën e parë dhe në plotësimin e ekspertizës financiare të kryer me datë 21.03.2016, duke konstatuar në fund të pasusit të faqes së parë, të ekspertizës plotësuese se listat e prezantuara nga KEDS, sipas të cilave është bërë ekzekutimi nuk janë identike me listat të cilat janë prezantuar departamentit të thesarit të Komunës dhe se në këto lista specifikuese gjatë rrugëtimit nga Komuna deri te KEDS-i, si ekzekutues dikush në fshehtësi ka bërë ndryshime të pjesshme të pronarëve të shfrytëzuesve të njehsorëve elektrik. Ka shtuar se konstatimi i këtillë i ekspertit financiar në ekspertizën plotësuese përputhet në tërësi me mbrojtjen e të akuzuarit, se origjinali i listave të nënshkruara nga i akuzuari gjenden në thesarin e Komunës, ndërsa te ndryshimi i listave ka ardhur gjatë rrugëtimit prej Komunës në KEDS-ë, e në bazë të cilave edhe janë bërë pagesat, mirëpo i akuzuari nuk ka pasur qasje mbi dorëzimin e listave prej Komunës në KEDS-ë, e as që ishte në kompetencën e tij ta përcjellë bartjen e listave për në KEDS-ë, e as që ishte i njoftuar. Ka shtuar se me as një provë materiale me ekspertizën e ekspertit financiar, e as me deklaratat e dëshmitarëve të procedurë nuk është vërtetuar se i akuzuari i ka futur sipas përshkrimit në dispozitivit të akuzës, pagesat e rrymës së shpenzuesve tjerë, sepse i akuzuari nuk ka pasur kurrfarë kontakt me dëshmitarët e proceduar G. G. dhe N. H. në emër të cilëve janë bërë pagesat për shfrytëzimin e energjisë elektrike përkatësisht njehsorëve të tyre, të cilin fakt e kanë vërtetuar edhe dëshmitarët e propozuar dhe të cilët janë deklaruar se edhe ata nuk kanë njohuri se kush dhe pse ju ka bërë pagesat për shfrytëzimin e rrymës nga ana e buxhetit të Komunës. Ka theksuar se nuk është kontestues fakti se nga mjetet e buxhetit të Komunës, janë bërë pagesat për shfrytëzimin e energjisë elektrike dëshmitarëve të cekur por sipas regjistrave-listave krejtësisht tjera dhe pa nënshkrim të akuzuarit, pasi që listat të përpiluara nga i akuzuari në origjinal dhe për të cilat ka përgjegjësi i akuzuari janë në thesarin e Kuvendit të Komunës, si dhe kopjet e listave me nënshkrim në shkresat e lëndës të bëra nga i akuzuari dhe të nënshkruara, andaj nuk është vërtetuar pretendimi i akuzës siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës me asnjë provë se i akuzuari ka ndërmarre veprime për ndryshimin e listave për pagesën e borxheve, siç pretendon akuzat dhe i njëjti fakt nuk është provuar me asnjë provë por është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarre veprime konform detyrave dhe përgjegjësive të tij në punë, andaj i propozon gjykatës që konform dispozitave të KPPRK-së, të akuzuarin H. H. nga fshati R., Komuna Rahovec ta liroj nga akuzat për shkak se nuk është provuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Ka shtuar se po qese gjykata eventualisht konsideron se ekzistojnë provat se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar propozon dhe e lusin trupin gjykues që të ketë parasysh sidomos rrethanat lehtësuese që janë në favor të

akuzuarit, kuptohet me rastin e caktimit të llojit dënimit dhe gjatësisë së tij e prej rrethanave lehtësuese e cekë faktin se i akuzuari deri më tani është i padënuar, nuk zhvillohet ndonjë procedurë penale për vepra tjera penale, dëmi i shkaktuar relativisht është i vogël, gjendjen e tij familjare dhe ekonomike, pasi që është i vetmi ushqyes i familje katër anëtaresh prej atyre të tre fëmijëve të cilët janë student dhe nuk ka të ardhura tjera përveç pagës që është duke e marrë nga Komuna Rahovec, e sidomos faktin se ka të bëjë me të akuzuarin i cili lëngon nga sëmundja akute e rëndë, faktet të cilat janë vërtetuar edhe gjatë zhvillimeve paraprakisht të procedurës, gjendjen e ka të përkeqësuar shëndetësore, i duhet mjekim i vazhdueshëm dhe i përhershëm e te cilin fakt e vërtetojnë edhe me dy raporte mjekësore të datës 29.09.2016 të lëshuar nga specialisti si dhe raportin të datës 25.09.2014, të cilët ja prezanton gjykatës si provë, kështu që konsideron se me shqiptim të dënimit efektiv me burgimi kishte kontribuar në keqësimin e gjendjes së tij shëndetësore, duke i marrë parasysh kushte në qendrat për vuajtjet e dënimeve, i cili fakt është botërisht i ditur andaj konsideron dhe i propozon gjykatës që të akuzuarit ti shqipton një dënim me kusht duke konsideruar se edhe me këtë dënim nën rrethanat e cekura lehtësuese do të arrihet qëllimi i dënimit të parapara konform dispozitave të KPRK-së.

I akuzuari **H. H.** që në fillim të shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë, ndërsa gjatë mbrojtjes së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 28.09.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e mbrojtësit të tij avokatit M. B. ka deklaruar se në Kuvendin Komunal në Rahovec është punësuar nga muaji shtator i vitit 1999 në punë dhe detyra të punës arkëtar, ndërsa me vendimin e Kryetarit të Komunës i cili çdo fillim viti e cakton zyrtarin e shpenzimeve është caktuar edhe si zyrtar i shpenzimeve nga gjysma e vitit 2009. Ka shtuar se nga viti 2003, ka kryer punët dhe detyrat e punës zyrtar për paga, e cila ka qenë detyra e tij bazë, ndërsa detyrë dhe punë shtesë me vendim të Kryetarit të Komunës nga gjysma e vitit 2009 ka kryer edhe punët e zyrtarit të shpenzimeve, e ku zyrtari i shpenzimeve punon në bazë të Udhëzimit Administrativ 02/2009, gjegjësisht me nenin 8 të këtij udhëzimi, janë të definuar detyrat e zyrtarit të shpenzimeve si i pranon urdhër obligimet për pagesa nga zyrtari zotues, i verifikon a janë të nënshkruara nga zyrtarët e autorizuar, e vërteton se xhirollogaria e operatorit ekonomik të cilit duhet të lëshohen mjetet financiare, a është në përputhshmëri me ligjin, e vërteton se zyrtari zotues a ka bërë zotimin-alokimin e mjeteve aq sa janë në fatura dhe e dërgon lëndën për finalizim te zyrtari aprovues-certifikues. Ka theksuar se zyrtari zotues pas dhënies së lejes për pagesa urdhër obligimin ja dërgon zyrtarit shpenzues, e pastaj zyrtari shpenzues pasi pranon urdhër pagesat i regjistron si shpenzime në fri-balance i cili është sistem i thesarit, e pastaj i dërgon te zyrtari certifikues-aprovues, i cili fillimisht bënë verifikimin e faturave, e bënë sërish verifikimin e nënshkrimeve të zyrtarëve të mëparshëm, shikon se a janë ndarë mjetet në mënyrë të barabartë, sa është shuma e mjeteve të zotuara me ato nga faturat, pra bënë përputhshmërinë një nga një të faturave me mjetet e zotuara, si dhe e verifikon se a po shkojnë mjetet financiare në llogari të operatorit ekonomik i cili e ka lëshuar atë faturë dhe nëse përputhen të gjitha i miraton gjegjësisht i aprovon dhe i dërgon në arhivën e thesarit. Ka shtuar se lista e operatorëve përpilohet në momentin kur një operator ekonomik sjellë faturën dhe regjistrin e operatorëve ekonomik të cilin e përpilon vet, është i obliguar ta nënshkruaj dhe ta vendos datën dhe në periudhën kohore për të cilën është akuzuar në Komunën e Rahovecit nuk ka pasur person të caktuar që të pranoj faturat e operatorëve ekonomik, e po ashtu nga viti 2009 deri në vitin 2015, Komuna e Rahovecit nuk ka pasur shërbimin e dorëzuesve dhe për faturat e KEDS-it, në atë kohë pasi janë certifikuar nga certifikuesi nuk e dinë a kanë shkuar në KEK-ë, pasi vet kurrë nuk i ka dorëzuar as faturat, e as regjistrat në KEK-

ë. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit ka deklaruar se në atë periudhë kohore Komuna nuk ka pasur person të autorizuar, për pranimin e faturave, mirëpo pasi ato janë dorëzuar kanë shkuar në zyrën për ekzekutim apo realizim, e Komuna ka pasur një regjistër në origjinal me numrin e njehsorëve të cilët i ka poseduar, e faturat e KEDS-it, kanë ardhur njëherë në muaj, e ndonjë herë një herë në dy muaj, e pasi zyrtari autorizues i ka verifikuar faturat a përputhen me specifikacionin, e ka nënshkruar urdhër obligimin për pagesë, me të cilin e ka urdhëruar zyrtarin zotues që të ndaj atë shumë të mjeteve për pagesën e atyre faturave. Ka shtuar se është nga fshati R. Komuna Rahovec, dhe sa i kujtohet në vitin 2012 në qytetin e Rahovecit e ka blerë një banesë e cila gjendet në rr. "Xhelal Hajda-Toni" në katin e dytë të banimit nga qytetarja Z. F., e për të cilën kanë përpiluar kontratë mbi shit-blerjen të cilën kontratë e kanë vërtetuar edhe në gjykatë. Ka theksuar se kur e ka blerë banesën rryma ka qenë e pa paguar në shumën prej 3700-4000,00 €, i cili fakt është e konstatuar edhe në kontratën e shit-blerjes e ku ato shpenzime i ka marrë përsipër shitësja e së bashku me shitësen kanë shkuar në Habitat në Prizren, pasi Habitat-i, në atë kohë kur minoritarët bënin shit-blerjen e banesave i lironin nga pagesa, e kur ka shkuar në KEDS-ë, që ta përkthej njehsorin elektrik në emrin e tij apo të bashkëshortes zyrtarët e KEDS-it, i kanë thënë se pa ardhur vendimi nga Habitat-i, nëse e kthejnë njehsorin në emrin tuaj atëherë i merrni për sipër tërë borxhin edhe tani mund të verifikohet në KEDS-ë, se kurrë nuk ka paguar rrymë pasi nuk e paguan pa u rregulluar çështja me Habitat-in. Ka shtuar se banesën e ka blerë në shumë prej 10,000,00 €, dhe nuk ka parashtruar padi ndaj shitëses, pasi ajo nuk jeton në Kosovë dhe kur e ka blerë banesën ajo ka qenë e zbrastë e demoluar dhe në këtë banesë nuk ka jetuar G. G., ndërsa nuk ka për dijeni që N. H. ka jetuar aty, pasi kur e ka blerë banesën ajo ka qenë e lirë, e kur ka shkuar në KEK-ë, për çështjen e rrymës së shpenzuar i kanë treguar se rryma është në emrin e N. H.. Ka theksuar se kurrë nuk ka paguar për rrymën e shpenzuar në këtë banesë dhe për 5 (pesë) pagesat e bëra për rrymën e shpenzuar në këtë banesë e të cilat pagesa janë bërë nga xhirollogaria dhe buxheti i Komunës së Rahovecit nuk ka për dijeni se kush e ka dërguar regjistrin në KEDS-ë dhe nuk ka për dijeni se pse Komuna nga buxheti i saj e ka paguar rrymën e shpenzuar në këtë banesë. Ka shtuar se nga viti 2012-2014 në këtë banesë ndonjëherë ka qëndruar vetë por ua ka lëshuar edhe disa nxënësve të cilët i ka kushëri dhe faktin që nga buxheti i Komunës është paguar rryma e shpenzuar në këtë banesë ka theksuar se ndoshta ja ka bërë dikush pasi në atë vend të punës janë pranuar dy zyrtar të rinjë sepse atë e kanë transferuar në Drejtorinë për Administratë si zyrtar për pranimin e kërkesave. Ka shtuar se G. G. e ka njohur si figurë, punon si kurirë në shkollë, nuk ka për dijeni ku e ka banesën, pagesat e bëra nga Komuna për rrymën e shpenzuar në banesën e tij nuk i ka kthyer, sepse Kuvendi Komunal nuk i ka kërkuar që ta paguaj, pasi rryma nuk është në emrin e tij. Ka shtuar se para se të lidh kontratën e shit-blerjes nuk ka jetuar në këtë banesë, si dhe duke u përgjigjur në pyetjen se dëshmitari G. G. në shqyrtimin gjyqësor të datës 07.12.2015, ka deklaruar se të njeh dhe se gjatë vitit 2000-2003, keni jetuar në të njëjtën banesë dhe në të njëjtin kate, është përgjigjur se nuk i intereson se kush ka jetuar aty. Duke u përgjigjur në pyetjen se çfarë mund të thuani për ekspertizë financiare në të cilën është e konstatuar se lista e prezantuar në KEDS-ë, sipas së cilave është bërë ekzekutimi, nuk janë identike me listat e prezantuar në departamentin e thesarit dhe dikush gjatë rrugëtimit nga Komuna deri në KEDS-ë, ka bërë ndryshimin e pjesshëm dhe kanë shtuar numrat e njehsorëve 8000466 për të cilën është paguar shuma e tërësishme prej 1394,35 € dhe numrin e njehsorit 80016146 për të cilën është bërë pagesa në shumë prej 977,55 €, ka theksuar se specifikacioni në KEDS-ë, është dërguar nga kush ka mundur dhe nuk e dinë kush ka pasur interes ta bëjë atë pagesë dhe i tërë dokumentacioni ruhet në drejtorin e financave, e person i autorizuar është Xh. H..

Gjatë shqyrtimit gjyqësor me rastin e procedimit të provave, vlerësimit dhe analizimit të tyre një nga një, e pastaj në lidhje me njëra tjetrën, Gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari në periudhën kohore nga muaji tetor i vitit 2010 e gjerë me datë 22.04.2014, në Rahovec, duke qenë në pozitën e personit zyrtar për paga dhe pagesa në Kuvendin Komunal të Rahovecit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete ka keqpërdorur pozitën zyrtare, në atë mënyrë që për periudhën e lartë cekur kohore ka futur në faturat e pagesave të rrymës të shpenzuesve të energjisë elektrike pagesa e të cilave shpenzime bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit dhe atë njehsorin e energjisë elektrike me numër 80004660 në emër të shfrytëzuesit privat G. G. nga Rahoveci dhe atë shumën prej 1.394,35 €, si dhe njehsorin e energjisë elektrike me numër 80016146 në emër të shfrytëzuesit privat N. H. nga Rahoveci në shumën prej 977,55 €, ashtu që me këto veprime të kundërligjshme ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Rahovecit në shumë të përgjithshme prej 2.371,90 €.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dëshmia e dëshmitarit L. S. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015 dhe në prokurori me datë 22.10.2014, dëshmia e dëshmitarit G. G. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, dhe në prokurori me datë 22.10.2010, dëshmia e ekspertit financiar e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, dëshmia e dëshmitarit N. H. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 14.01.2016 dhe në prokurori me datë 22.10.2014, vendimi i Kryetarit të Komunës në Rahovec me numër 151 i datës 22.01.2014, Udhëzimi Administrativ 02/2009, përshkrimi i detyrave të punës të zyrtarit të pagave edhe pagesave, raporti i oficerit i datës 24.09.2014, fatura e KEDS-it e datës 01.01.2010 deri me datë 31.12.2014, në emër të N. H., gjashtë pagesat e faturave të rrymës elektrike për vitet 2013-2014, tri pagesat e faturave të rrymës për vitin 2014, fatura e KEDS-it, e datës 01.01.2010 deri me datë 31.12.2012, në emër të G. G., nëntë kopjet e pagesave të faturave të rrymës elektrike për vitet 2010 dhe 2011, pagesat e faturave të rrymës për vitet 2014 dhe 2012 së bashku me urdhër pagesat e datës 19.09.2013, urdhër blerja e Departamentit të Thesarit e datës 17.09.2013, urdhër pagesa e datës 19.07.2014, urdhër blerja e Departamentit të Thesarit e datës 13.02.2014, urdhër pagesa e datës 31.01.2014, vendimi i Komisionit Disiplinor i datës 08.08.2014, vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i datës 27.11.2014, shkresa me emërtim informatë lidhur me pagesat e rrymës në Kuvendin Komunal në Rahovec e datës 23.09.2014, e përpiluar nga L. S., ekspertiza financiare e datës 23.02.2015 si dhe plotësimi i ekspertizës financiare.

Dëshmitari **L. S.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se të akuzuarin H. H. e njeh nga data 06.02.2014, kur edhe është emëruar Drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, ka shtuar se është ekonomist i diplomuar dhe detyrat e tij të punës si drejtor i këtij Drejtorati është që të menaxhoi me buxhetin e Komunës së Rahovecit dhe në këtë Drejtori janë të punësuar 13 zyrtar, të cilët janë në mbikëqyrjen e tij, ndërsa për punën e vet i raporton Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë për Financa. Ka shtuar se pasi është emëruar si Drejtor me datë 06.02.2014, fillimisht është njoftuar me natyrën e punës, nuk ka vërejtur ndonjë parregullsi, mirëpo në Komitetin për Politik dhe Financa me datë 16.06.2014, nga asamblisti H. G. është ngritur kjo çështje, i cili ka kërkuar nga ai si Drejtor i Financave dhe

Drejtori i Shërbimeve Publike, që të vërtetohet se pse paguhen disa njehsor elektrik privat nga buxheti i Komunës, edhe pse nuk janë pjesë e shpenzimeve të Komunës. Ka theksuar se pas mbledhjes së këtij Komiteti, ka shkuar që ta verifikoi këtë fakt dhe ka bërë krahasimin e njehsorëve elektrik, që kanë pasur në listë dhe ato që kanë qenë në listat e KEDS-it, kanë qenë të ndryshme, pasi në listën e KEDS-it, ka pasur numër më të madh të njehsorëve elektrik, e kanë verifikuar se kush janë pronarët e atyre njehsorëve që gjenden në listat e KEDS-it dhe kanë kërkuar nga KEDS-it të japin pasqyrën-gjendjen e shpenzimeve dhe aty kanë konstatuar se pagesa e energjisë së shpenzuar në këta njehsor elektrik është bërë nga buxheti i Komunës. Ka shtuar, se gjithsejtë kanë qenë 46 njehsor, me të cilët ka qenë e ngarkuar Komuna e Rahovecit dhe pronarët të njehsorëve elektrik të cilët janë paguar nga buxheti i Komunës, por që nuk kanë qenë në shfrytëzim të Komunës, janë njehsorët e regjistruar në emër të N. H., G. G. dhe një njehsorë i cili i ka takuar ndriçimit publik të varrezat te fshati P. dhe pas verifikimit është konstatuar se këto keqpërdorimet janë bërë nga muaj tetor 2010 deri në muaj prill 2014 dhe vlera e dëmit të shkaktuar ka qenë 2371,90 €, e kjo shumë ka të bëjë me njehsorët elektrik të regjistruar në emër të N. H. dhe G. G., pasi rryma e shpenzuar për ndriçimin publik të varrezave në fshatin P. është hequr, sepse është obligim i Komunës ta bëjë pagesën e këtyre shpenzimeve. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit H. H., avokati T. B. ka theksuar se kur është emëruar Drejtor me datë 06.02.2014, i akuzuari H. H. e ka pasur vendin e punës zyrtar i pagave dhe si punë shtesë edhe zyrtar për pagesa dhe për punën shtesë për të cilën ka qenë i angazhuar ekzistojnë dosjet në zyrën e personelit dhe i akuzuari edhe më parë ka qenë duke i kryer këto punë dhe nga zyra e personalit ka marrë përgjigje verbale për këtë fakt. Ka theksuar se për çdo fillim të vitit fiskal Kryetari i Komunës nxjerr vendimin me të cilët përcakton rolin e së cilit nga zyrtarët që nënshkruajnë urdhër pagesën, e në urdhër pagesën me numër 48969 i akuzuari H. H. ka dy nënshkrime në urdhër obligim për pagesë, dhe atë si zyrtar i përgatitjes së dosjes në Drejtorinë për Financa dhe si zyrtar i pagesave, pra i akuzuari fillimisht e ka përgatitur lëndën me të gjitha faturat, me specifikacion dhe e ka dërguar te zyrtari kompetent Drejtori i Shërbimeve Publike që ka qenë Përparim Krasniqi, e pastaj vet i akuzuari H. H. e kthen te zyrtari zotues, që në këtë rast është G. K., i cili bënë zotimin e mjeteve financiare në sistem, e më poshtë H. H. e bënë nënshkrimin si zyrtar i pagesave dhe në fund para se mjetet të dalin në llogari këtë veprim e certifikon zyrtari certifikues, e në këtë rast H. H.. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtjes se në deklaratën e juaj të dhënë në prokurorit me datë 22.10.2010 në faqen e 5-të, pasusi i I-rë, keni theksuar se periudha kohore e keqpërdorimit ka qenë vitit 2008-2009 dhe në pyetjen e cila është e vërteta ka theksuar se periudha 2008-2009,

është periudha të cilën e kanë konstatuar policia financiare, ndërsa sot është përgjigjur për konstatimet e tij si drejtor i kësaj drejtorie dhe urdhër pagesat e shpenzimeve të energjisë elektrike në KEDS-së, ka pasur raste kur i ka dërguari akuzuari H. H., por në shumicën e rasteve KEDS-së, vinë e i marrin specifikacionet, te i akuzuari H. H. dhe Komuna nuk ka person të emëruar për dorëzimin e specifikacioneve në KEDS-së, dhe pasi i shikon fletë pagesat e njësitit elektrik që i përket N. H. e që është shënuar BVI-ja për kulturë fizike dhe është nënshkruar nga i akuzuari përgjigjet se vërtetësinë e njehsorit elektrik e saktëson numri i njehsorit, e jo emërtimi, pasi mund të emërtoi si të dojë dhe se kanalizimi i pagesave te KEDS-së, bëhet në bazë të numrit të njehsorëve. Ka shtuar se ka për dijeni se ku ndodhet banesa e N. H. dhe se kjo banesë nuk ndodhet te BVI- ja, se te ndërtesa e BVI-së janë zyre, kurse banesa e N. H. është për banim.



Dëshmitari **G. G.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar të akuzuarin H. H. e njeh nga koha kur ka shkuar që të banoj, pra kanë banuar në të njëjtë banesë në vitin 2000-2003 dhe i akuzuari për të banuar në këtë ndërtesë ka ardhur pas tij. Ka shtuar se banesa ku është vendosur që të banon ka qenë e qytetarit O. F., fillimisht ka hyrë pa pagesë, e më vonë qiranë ja ka paguar vëllait të tij dhe me të akuzuarin H. banesat i kanë pasur në të njëjtin kat, në të cilën ka ndenjur deri në vitin 2003 dhe nuk e dinë kush është vendosur pastaj dhe faturat e rrymës në këtë banesë kanë ardhur në emrin e tij pasi KEDS-i, e ka regjistruar njehsorin në emrin e tij.

Eksperti financiar **A. Sh.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka theksuar se është ekonomist i diplomuar tani është në pension, por nga gjykata është i emëruar ekspert financiar gjyqësor, e më parë ka punuar në Kuvendin e Komunës në Gjakovë, Doganë, Shërbim të Kontabilitetit dhe Bankë dhe ka përvojë të punës rreth 30 vjeçare dhe gjatë kohës si ekspert gjyqësor, nuk e dinë saktësisht por mund të jetë që ka kryer mbi 100 ekspertiza. Ka shtuar se në këtë çështje ekspertizën e ka kryer sipas urdhëresës kur është kërkuar që ekspertin financiar ta përcaktoi lartësinë e dëmit që ka pasuar Komuna në Rahovec, ta përcaktoi periudhën kohore kur ka filluar ky keqpërdorim si dhe kohëzgjatje si dhe në sa njehsor elektrik është kryer keqpërdorimi dhe si ekspert financiar bazuar në dokumentacion ka arritur tek konkluzioni se nga veprimet e të akuzuarit Kuvendi Komunal ka pësuar dëm në shumën prej 2371,90 €, pagesat kanë qenë të herë pas hershme jo në vazhdimësi, që nga muaji tetor viti 2010, deri në muaj prill të vitit 2014, dhe është konstatuar se këto pagesa janë kryer në dy njehsorët elektrik dhe atë në njehsorin elektrik me numër 80004660 shuma e paguaj 1394,35 €, ndërsa në njehsorin e dytë me numër 80016146 shuma e paguar ka qenë 977,55 €, këto janë konstatimet të cilat si ekspertin financiar i ka nxjerr në bazë të urdhëresës dhe dokumentacionit që i është ofruar. Duke u përgjigjur në pyetjet e prokurorit se në njehsorin me numër 80016146 janë cekur disa data a nënkupton kjo se këto janë datat kur janë bërë pagesat për rrymën e shpenzuar nga ky njehsor, është përgjigjur po, këto janë data kur janë ekzekutuar pagesat, pasi Komuna e bënë pagesën e shumës së tërësishme për të gjithë njehsorët elektrik sipas listës e pastaj KEDS-i, e bënë shpërndarjen e pagesave sipas numrit të njehsorëve elektrik të dhëna në listë. Ka shtuar se në njehsorin elektrik me numër 80004660 në të cilën vlera e dëmit 1394,35 €, kjo shumë është paguar në dy herë. Duke u përgjigjur në pyetjet e mbrojtësit të akuzuarit avokatit T. B. ka theksuar se nuk ka qenë në zyrën e thesarit në Komunën e Rahovecit, për ta verifikuar dokumentacionin, por ka theksuar se pa nënkuptuar se kush e ka kryer këtë veprim, personi ka qenë shumë perfid, i ka krijuar dy parë lista, pra një listë ka qenë e Kuvendit të Komunës, ndërsa lista tjetër e cila është ekzekutuar është përpiluar në atë mënyrë që shuma totale ka qenë e njëjtë me listën e Kuvendit të Komunës, por që nga lista e ekzekutimeve është hequr ndonjë njehsor në emër të Kuvendit të Komunës dhe është futur njehsori tjetër si dhe për të verifikuar këto nuk ka qenë në KEDS-ë, pasi ekspertizën e ka bërë në bazë të dokumentacionit që ka pasur në shkresat e lëndës prokuroria e i cili dokumentacion ka qenë në fotokopje. Duke u përgjigjur në pyetjen se si e keni konstatuar se këta dy numra të njehsorëve që i keni shënuar nuk kanë qenë të Kuvendit të Komunës është përgjigjur, këta njehsor i ka reklamuar Kuvendi i Komunës dhe në bazë të dokumentacionit që ka lexuar ka vërejtur se dikush nga ana e KEDS-it, i ka lajmëruar asamblistët dhe pasi mbrojtësi ja ofron në shikim urdhër obligimin për pagesë me numër 48969 dhe duke u përgjigjur në pyetjet a i keni parë ju këtë shkresë, është përgjigjur po i ka parë dhe nënshkruar të këtij urdhër pagese janë zyrtarët komunal ku japin urdhëresa për

pagesë dhe H. H. si referent ja ka ofruar dokumentacionin udhëheqësve të vet që duhet të bëhet një pagesë, e këta tre zyrtarët janë udhëheqësit që vendosin për të bërë pagesa. Duke u përgjigjur në pyetjet tjera të mbrojtësit se a kanë mundur udhëheqësit e H. H. gjegjësisht nënshkruesit tjerë të konstatojnë se i akuzuari po vendos njëshor tjetër për pagesë është përgjigjur se eprorët e tij janë vendosur në lajthitje se kur ju është ofruar lista e pagesave nuk kanë qenë të shënuara numrat e këtyre dy njëshorëve, ndërsa kush e ka dërguar listën tjetër në KEDS-ë, nuk e dinë, por aty shuma ka qenë e njëjtë, por janë hequr dy njëshor dhe janë futur këta dy njëshor dhe në bazë të shkresave në lëndë është vërejtur se janë dy parë lista dhe ka qenë e vështirë të vërtetohet kjo, pasi shuma totale është përputhur por është vërejtur se numrat e njëshorëve janë të ndryshëm. Duke u përgjigjur në pyetjet e të akuzuarit H. H. se pse pasi janë formuar dy lista njëri i dërguar nga Komuna, e tjetri në KEDS-ë, në shumën e njëjta, pse nuk je bazuar në formularët e Komunës ku ekziston edhe origjinali por je bazuar në formularët e KEDS-it, që nuk dihet se kush i ka dërguar, është përgjigjur se obligim ka qenë për ta konstatuar dëmin që ka pësuar Komuna dhe detyra e zyrtarit certifikues është për ta bërë verifikimin e dokumentacionit.

Dëshmitari **N. H.** gjatë dëshmisë së tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 14.01.2016, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e prokurorit ka deklaruar, se të akuzuarin H. H. deri ditën e sotme nuk e ka njohur, e po ashtu nuk e njeh as L. S., e tani jeton në shtëpinë e tij që ndodhet në rr. "...” në Rahovec dhe në këtë shtëpi jeton për afërsisht 7-8 vite, kur edhe e ka lëshuar banesën. Ka shtuar se pas luftës ka jetuar në banesën e cila gjendet në rr. "Xhelal Hajda-Toni" në të cilën tani jeton H. H. dhe nuk e dinë saktësisht por mund të jetë viti 2007-2008 kur e ka lëshuar këtë banesë, e cila ka qenë në katin e III-të, banesa ka qenë e qytetarit B. F., i cili ka punuar në KEK-ë dhe në këtë banesë është vendosur vet, pronari nuk ka qenë, banesa ka qenë e zbrastë dhe ka qenë i treti person që ka banuar aty, pasi që dy familje para tij kanë jetuar në atë banesë. Ka shtuar se nuk i kujtohet saktësisht por mund të jetë viti 2000, kur është vendosur në atë banesë dhe kur ka dal nga banesa çelësat e kësaj banese ja ka dorëzuar bashkëshortes së B. F., e cila ka shkuar së bashku me policinë. Ka shtuar se asnjëherë nuk e ka paguar rrymën elektrike në këtë banesë, ka qenë i pa punë, ka qenë ushtar dhe invalid i luftës dhe faturat e rrymës kanë qenë në emër të pronarit të banesës dhe bashkëshortja e pronarit nuk ka kërkuar që ta paguaj rrymën, vetëm i ka kërkuar çelësat dhe e ka njoftuar se është duke e shitur banesën. Ka theksuar se ora elektrike ka qenë e vendosur te hyrja e katit të parë dhe shtëpia ku banon tani, është në largësi nga kjo banesë afërsisht 2 km dhe djali i axhës B. H., i ka treguar se në këtë banesë është vendosur i akuzuari H. H., e për të cilin fakt i ka treguar 5-6 ditë, pasi ja ka dërguar çelësat bashkëshortes së B. F.. Ka shtuar se më parë nuk e ka parë të akuzuarin, nuk e dinë sa kohë ka qëndruar ai në banesë dhe ka theksuar se nuk është i sigurt se në emër të kujt kanë qenë faturat e energjisë elektrike, por më lartë ka theksuar se kanë qenë në emër të B. F., bazuar në faktin se ai është pronar, pasi vet nuk i ka shikuar në emër të kujt janë faturat, sepse vet asnjë herë nuk ka paguar. Ka theksuar se një kat përfund kësaj banese ka jetuar S. B., ndërsa në katin ku ka jetuar vet nuk ka jetuar askush, me S. B., kanë pasur vizita të ndërsjella dhe të akuzuarin gjatë kohës sa ka qëndruar në këtë banesë, nuk e ka parë duke hyr, por pasi e ka lëshuar banesën, është vendosur i akuzuari si dhe edhe S. B. e ka liru banesën e tij dhe jeton në fshatin D., Komuna Rahovec. Duke u përgjigjur në pyetjet e përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar B. O., ka theksuar se nuk ka për dijeni se kush e ka paguar energjinë e harxhuar në këtë banesë, pasi vet nuk ka paguar asnjë herë dhe gjatë kohës sa ka jetuar në këtë banesë, këtu nuk ka jetuar G. G., të cilin nuk e njeh, e as O. F. a nuk ka qenë duke jetuar në këtë

hyrje, pasi në këtë ndërtesë kanë qenë vetëm tri banesa, në katin e II-të, tri banesa, në katin e III-të, tri banesa dhe duke jetuar ka qenë vetëm ai me familjen e tij në katin e III-të dhe S. B. me familjen e tij në katin e II-të.

Nga vendimi i Kryetarit të Komunës 01 numër 151 të datës 22.01.2014, është konstatuar se janë emëruar personat zyrtar autorizues, zotues, certifikues dhe i prokurimit për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2014 dhe i akuzuari H. H. është emëruar zyrtar i shpenzimeve.

Me Udhëzimin Administrativ 02/2009, që rregullon Delegimin e Menaxhimit të Shpenzimeve të Organizatave Buxhetore janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit e personave të emëruar për mbikëqyrjen e shpenzimeve të buxhetit të organizatave buxhetore, e me nenin 8 të këtij udhëzimi, janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit të shpenzimeve të cilën detyrë e ka kryer i akuzuari.

Nga përshkrimi i detyrave të punës të zyrtarit të pagave dhe pagesave të datës 02.10.2013, janë të përcaktuara detyrat dhe përgjegjësit që ka zyrtari i pagave dhe pagesave.

Nga raporti i oficerit i datës 24.09.2014, është e konstatuar se Njësi Kundër Krimeve Ekonomike në Prizren me datë 30.07.2014 ka pranuar një informatë nga Njësia për Inteligjencë për dyshimin që H. H. i punësuar në Kuvendin Komunal në Rahovec, e ka keqpërdorur buxheti e Komunës, duke paguar faturat e rrymës të amvisërisë me para të Kuvendit të Komunës dhe i njëjti është intervistuar me datë 24.09.2014.

Nga fatura e KEDS-it, e datës 01.01.2010 deri me datë 31.12.2014 është e konstatuar se njehsori elektrik me numër 80016146 në adresën “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, e ka qenë i regjistruar në emër të qytetarit N. H. dhe gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë 6 (gjashtë) pagesa nga faturat-pagesat e rrymës për vitin 2013-2014, si dhe është e konstatuar se ky njehsorë elektrik me numër 80016146, gjendet në listë dhe është paguar nga buxheti i Komunës së Rahovecit.

Nga fatura e KEDS-it, e datës 01.01.2010 deri me datë 31.12.2014, është e konstatuar se njehsorë elektrik me numër 80004660 në adresën “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, ka qenë i regjistruar në emrin e qytetarit G. G., me të cilën faturë është e vërtetuar se janë bërë dy pagesa.

Nga faturat-pagesat e rrymës elektrike të shpenzuar për vitet 2010, 2011, 2012 janë të konstatuar numrat e njehsorëve elektrik që janë në pronësi të Komunës së Rahovecit dhe pagesat e bëra për energjinë e shpenzuar nga këta njehsor elektrik.

Nga urdhër-blerjet e Departamentit të Thesarit të datës 17.09.2013 dhe 13.02.2014 dhe urdhër-pagesat e datës 19.09.2013 dhe 31.04.2014, janë të konstatuara nënshkrimet e të gjithë zyrtarëve të autorizuar për pagesën e faturave të KEDS-it, e ku është edhe nënshkrimi i të akuzuarit H. H..

Nga pagesa e faturave të rrymës elektrike për muajin e VIII-të, të vitit 2013 është e shënuar njësori me emërtimin BVI për kulturë fizike me numër 80016146 me shpenzime 0,00, e cila shkresë-faturë është nënshkruar nga H. H., pastaj nga pagesa e faturës për muajin e VII-të, të vitit 2013 sërisht njësori është emërtuar BVI për kulturë fizike me numër 80016146 shuma e shpenzimeve të paguara është prej 32,00 €, e nënshkruar nga H. H..

Nga pagesa e faturës për muajin e I-rë, të vitit 2014, e nënshkruar nga H. H. shuma e tërësishme-totale e pagesës për rrymën e shpenzuar nga të gjithë njësoret elektrik ka qenë 11.234,95 €, ndërsa po ashtu në pagesën e faturës së rrymës për muajin e I-rë, të vitit 2014 e pa nënshkruar nga i akuzuari shuma e tërësishme e pagesës është e njëjtë 11.234,05 €, mirëpo tani në numrin rendor 39 figuron edhe njëtori me numër 80004660 me shpenzime të rrymës në shumën prej 350,46 € dhe në numrin rendor 35 edhe njëtori me numër 80016146 me shpenzime të rrymës në shumën prej 135,26 €.

Me vendimin e Komisionit Disiplinor me numër 03/2014 i datës 08.08.2014, është e konstatuar se H. H. i sistemuar në punët dhe detyrat e punëve zyrtarë për paga dhe pagesa është shpallur përgjegjës dhe i është shqiptuar masa disiplinore pezullim parandalues me pagesë për 2 (dy) muaj.

Me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A/2/523/2014 i datës 27.11.2014, është shfuqizuar vendimi i komisionit disiplinor me numër 03/2014, i datës 08.08.2014 dhe vendimi 01-3582 i datës 26.09.2014 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Rahovecit dhe është detyruar komisioni disiplinor që ta bëjë rishqyrtimin e rastit disiplinor kundër H. H..

Nga shkresa me emërtimin informatë lidhur me pagesën e rrymës së shpenzuar në Kuvendit Komunal në Rahovec, të datës 23.09.2014 është e konstatuar se L. S. si Drejtor i Drejtorisë të Buxhet dhe Financa ka njoftuar policinë e Kosovës për pagesat dhe shumën e pagesave për energjinë e shpenzuar.

Nga ekspertiza financiare e përpiluar nga eksperti financiar A. Sh. e datës 23.02.2015, është e konstatuar se nga buxheti i Kuvendit Komunal për dy njësorët elektrik janë paguar të holla dhe atë për njëtorit me numër 8000466 është paguar shuma prej 1394,35 €, ndërsa për njëtorin elektrik me numër 80016146 për energjinë e shpenzuar në këtë njëtorë është paguar shuma prej 977,55 €, si dhe ka konstatuar se shuma totale e dëmit që ka pësuar Komuna është 2.371,80 €, nga pagesa që janë bërë për dy njësorët elektrik të cilët nuk i kanë takuar Kuvendit Komunal të Rahovecit por amvisërisë.

Nga plotësimi i ekspertizës financiare e datës 21.03.2016, është konstatuar se eksperti financiar A. Sh. sipas urdhëresës së gjykatës pas shikimit të serishëm të dokumentacionit i cili ka qenë te prokurori i çështjes, ka vërtetuar se nuk është gjetur asgjë e re, pra shuma e tërësishme e dëmit që ka pësuar Kuvendi Komunal është prej 2.371,90 € për pagesën që është bërë për njësorët elektrik të cilët nuk i kanë takuar Kuvendit Komunal.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e prokurorisë të parashtruara si në aktakuzë, ashtu edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, pretendimet e mbrojtjes të parashtruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dhe të gjitha provat e administruara veç e veç, e pastaj të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe ka konstatuar se i akuzuari H. H. e ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e të akuzuarit të parashtruara gjatë mbrojtjes së tij se nuk ka për dijeni se kush me buxhetin e Komunës i ka bërë pagesat për rrymën e shpenzuar në këta njësor elektrik dhe se ndoshta ja ka bërë dikush me qëllim, pasi në vendin e tij të punës janë pranuar dy zyrtar të rij, ndërsa atë e kanë transferuar në Drejtorinë e

Administratës si zyrtar për pranimin e kërkesave dhe gjykata ka konstatuar se pretendimet e tilla të akuzuarit janë vetëm deklarative të pabazuara dhe argumentuara me asnjë provë apo dëshmi, pasi sipas vlerësimit të gjykatës nuk qëndron pretendimi i të akuzuarit që dikush me qëllim të paguaj nga buxheti i komunës, pikërisht energjinë e shpenzuar në banesën të cilën e ka blerë vet i akuzuari dhe në banesën tjetër e cila ka qenë në emër të G. G..

Gjykata pretendimin e të akuzuarit se nuk ka pasur për dijeni se nga buxheti i Komunës është paguar për energjinë e shpenzuar është i pa bazuar e ka argumentuar dhe vërtetuar edhe nga vet pagesat e faturave të rrymës elektrike për vitin 2013, të bëra nga Komuna e Rahovecit, e pikërisht prova-shkresa me emërtimin pagesa e faturave për vitin 2013, e evidentuar në shkresat e lëndës me numrin rendor 114, pagesa e bërë për muajin e VIII-të, të vitit 2013, saktësisht është e vërtetuar se është e shënuar njehsori me emërtimin BVI-ja për kulturë fizike me numër të njehsorit 80016146, pagesa është 0,00, mirëpo ky njehsor në këtë numër është i regjistruar në emër të N. H. dhe i përket banesës të cilën e ka blerë i akuzuari nga Z. F. dhe kjo tabelë ku gjenden edhe emrat e njehsorëve dhe numrat e tyre, që i përkasin Komunës së Rahovecit, e në të cilën tabelë është edhe njehsori i banesës të cilën e ka blerë i akuzuari dhe se kjo tabelë-pagesë e faturave të rrymës për muajin e VIII-të, të vitit 2013, është nënshkruar nga i akuzuari H. H. si zyrtar për paga dhe pagesa.

Gjykata të njëjtin fakt e ka vërtetuar edhe nga tabela tjetër me listat e njehsorëve të dërguar për pagesë për muajin e VII-të, të vitit 2013, e evidentuar në shkresat e lëndës me numrin rendor 120, ku sërish në mesin e njehsorëve pronë e Komunës gjendet edhe njehsori me numër 800161146, i emërtuar si njehsor që i përket BVI-së për kulturë fizike, e që në realitet është njehsori i cili i përket banesës që e ka blerë i akuzuari i cili ka qenë i regjistruar në emër të N. H. dhe nga buxheti i Komunës së Rahovecit, është paguar për energjinë e shpenzuar në këtë njehsor shuma prej 32,00 €, si edhe kjo faturë është nënshkruar nga i akuzuari H. H. si zyrtar për paga dhe pagesa, andaj sipas vlerësimit të gjykatës bazuar në faktin që i akuzuari e ka blerë banesën në vitin 2012, ndërsa pagesat për këtë njehsor elektrik nga buxheti i Komunës janë bërë gjatë vitit 2013, pra pas 1 (një) viti, pasi i akuzuari e ka blerë banesën dhe është vendosur në të, nënkupton që i akuzuari e ka ditur numrin njehsorit dhe qëllimisht duke e ndërruar emërtimin dhe duke emërtuar si njehsor që i takon BVI-për kulturë fizike, pra e ka vendosur numrin e njehsorit që i ka takuar banesës të cilën e ka blerë dhe me dashje dhe dijeni të plotë e ka paguar energjinë e shpenzuar nga ky njehsor nga buxheti i Komunës së Rahovecit.

Pretendimin e të akuzuarit se dëshmitarin G. G. e njeh vetëm si figurë dhe nuk ka për dijeni se ku e ka banesën, gjykata e ka analizuar dhe ka vërtetuar se pretendimi i tillë i të akuzuarit është në kundërshtim me deklaratën e dëshmitarit G. G. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 07.12.2015, i cili ka theksuar se të akuzuarin e njeh dhe me të akuzuarin ka jetuar në të njëjtin kat, e ku i akuzuari i pranishëm kur dëshmitari ka dhënë këtë dëshmi fare nuk e ka kundërshtuar, si dhe gjatë mbrojtjes së tij kur i akuzuari është ballafaquar me dëshminë e këtij dëshmitari ka theksuar se nuk i intereson se kush ka jetuar aty, andaj bazuar në këto dëshmi, gjykata pretendimeve e të akuzuarit të parashtruara gjatë mbrojtjes së tij nuk ja ka falur besimin, pasi deklaratimet e tija ishin kontradiktore jo vetëm në vetveten por edhe me provat tjera të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore, si dëshmia e dëshmitarit N. H. i cili ka theksuar se asnjëherë nuk ka paguar për energjinë e shpenzuar në banesën të cilën e ka blerë i akuzuari, dëshminë e dëshmitarit L. S. i cili ka theksuar se pasi kanë marrë informacionin se nga buxheti i Komunës po paguhet energjia e shpenzuar për dy njehsor elektrik privat, pas verifikimit kanë

konstatuar se njëri njehsor i përket qytetarit N. H., e tjetri qytetarit G. G., e i akuzuari H. H. si zyrtar i pagesave ka pasur raste kur i ka dërguar urdhër-pagesat e shpenzimeve elektrike në KEDS-ë, por në shumicën e rasteve kanë ardhur zyrtarët e KEDS-it, e i kanë marruar specifikacionet të akuzuari H. H., andaj gjykata pretendimeve të akuzuarit të parashtruara gjatë mbrojtjes së tij nuk ja ka falur besimin dhe e ka konsideruar vetëm përpjekje e të akuzuarit për të ju shmangur përgjegjësisë penale që ka për këtë vepër penale.

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit i cili ka theksuar se i akuzuari ka vepruar në tërësi në pajtim me vendimin dhe udhëzimin administrativ, e kjo gjendje është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar A. Sh., se listat e prezantuara nga KEDS-i, sipas së cilave është bërë ekzekutimi nuk janë identike me listat të cilat janë prezantuar Departamentit të Thesarit të Komunës dhe dikush në fshehtësi, gjatë rrugëtimit nga komuna deri në KEDS-ë, ka bërë ndryshimin e pjesshëm të pronarëve, të shfrytëzuesve të njehsorëve elektrik dhe me asnjë provë, e as nga ekspertiza financiare dhe deklaratat e dëshmitarëve, nuk është vërtetuar se i akuzuari pagesat e rrymës së shpenzuesve tjerë që nuk i takojnë komunës i ka vendosur për pagesa nga buxheti i komunës dhe gjykata ka vlerësuar se pretendimi i tillë i mbrojtësi është i pabazuar për faktin se fillimisht detyrë e ekspertit financiar nuk është që të zbuloj dhe hetoj se kush i ka vendosur në listat e pagesave nga buxheti i komunës njehsorët elektrik që i takojnë personave privat, por detyra e tij është që nga provat e bashkëngjitura si faturat mbi shpenzimet e energjisë elektrike të caktoj lartësinë e dëmit që e ka pësuar komuna, e ku eksperti financiar si në ekspertizën e parë ashtu edhe në plotësimin e ekspertizës në mënyrë të qartë e ka saktësuar se nga buxheti i komunës për shpenzimet e energjisë elektrike në njehsorin me numër 800046660 i regjistruar në emër të qytetarit G. G. janë paguar të hollat në shumë prej 1.394,35 €, ndërsa për energjinë e shpenzuar në njehsorin elektrik në numër 80016146 i regjistruar në emër të qytetarit N. H. nga buxheti i komunës janë paguar të hollat në shumë prej 977,55 € dhe eksperti financiar ka konstatuar se lartësia e dëmit që ka pësuar komuna e Rahovecit është në shumën prej 2.371,90 €.

Gjykata pretendimin e mbrojtjes se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka ndërmarrë veprime për ndryshimin e listave për pagesën e borxheve, është i pabazuar e ka vërtetuar edhe nga listat e pagesave për energjinë elektrike për vitin 2013, gjegjësisht tabelat me numrat e njehsorëve elektrik për muajin VII-të, të vitin 2013, muajin e VIII-të të vitit 2013, ku këto tabela janë nënshkruar pikërisht nga i akuzuari H. H., si zyrtar për paga dhe pagesa e në të cilat tabela gjendet edhe njehsori me numër 80016146 i cili është shënuar me emërtimin BVI-ja për kulturë fizike, e në realitet është njehsori elektrik i regjistruar në emër të qytetarit N. H., gjegjësisht në banesën të cilën e ka blerë i akuzuari.

Gjykata faktin se nga ana e të akuzuarit janë ndryshuar lista e pagesave për njehsorët elektrik e të vërtetuar edhe nga ana e ekspertit financiar e ka konstatuar edhe nga pagesa e faturave të rrymës për muajin I-rë, të vitit 2014 e evidentuar në shkresat e lëndës me numrin rendor 113, ku janë të evidentuara gjithsejtë 46 njehsor dhe shuma totale e shpenzuar është 11.234,50 €, e cila është e nënshkruar nga i akuzuari H. H. si zyrtar për paga dhe pagesa, ndërsa në listën tjetër e cila është dërguar në KEDS-ë, dhe është e ndryshuar, por është fjala për muajin e njëjtë të I-rë të vitit 2014, në shumë të njëjtë totale prej 11.234,05 €, e evidentuar në numrin rendor 131, por tani me dallim se janë shtuar njehsorët 80016146 për pagesë në shumën prej 135,26 €, njehsori 80004660 në shumën prej 350,46 €, ndërsa nga tabela e parë e nënshkruar nga i akuzuari e cila ju është ofruar për nënshkrim edhe zyrtarëve tjerë të banesës

është njehsori me numër rendor 37 me emërtim pompa e ujit në Hoqë të Madhe në shumën e pagesës prej 835,94 €, ndërsa në tabela e cila është përpiluar dhe ndryshuar nga i akuzuari H. H. ekziston edhe ky njehsor me numër 9026839, që i përket pompës së ujit Hoqë e Madhe, por tani vlera e pagesës për këtë njehsor është zvogëluar në shumën prej 225,60 €, mirëpo janë shtuar për pagesë të dy njehsorëve privat dhe shuma totale e dy faturave ka qenë e njëjtë andaj këtu gjykata saktësisht ka vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprim, pasi këtë fakt e ka dëshmuar edhe dëshmitari L. S., pastaj G. G. dhe N. H., të cilët gjatë dëshmisë së tyre kanë theksuar se asnjëherë nuk kanë paguar për energjinë e shpenzuar dhe nga pagesat e faturave për energjinë e shpenzuar është konstatuar se pagesa është bërë vetëm nga buxheti i komunës.

Gjykata nga provat e administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore ka konstatuar se i akuzuari këtë veprë penale e ka kryer nga muaji tetor 2010 deri në datë 22.04.2014, e këtë fakt e ka vërtetuar nga fatura e KEDS-it, e datës 01.01.2010 deri me datë 31.12.2014, e që ka të bëjë me njehsorin elektrik me numër 800046660, i cili është i regjistruar në emër të qytetarit G. G. e nga e cila fatura shihet se janë bërë dy pagesa dhe atë pagesa e parë është bërë me datë 21.10.2010 ndërsa pagesa e dyte me datë 21.02.2014, si dhe nga faturat e KEDS-it, për njehsorin elektrik me numër 80016146 i regjistruar në emër të qytetarit N. H. është konstatuar se gjatë vitit 2013-2014 janë bërë 6 (gjashtë) pagesa, ku pagesa e fundit është bërë me datë 22.04.2014, e po ashtu e njëjta gjendje faktike është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit financiar A. Sh., dëshmia e dëshmitarit L. S., i cili si drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet ka theksuar se pasi kanë marrë informatat se nga buxheti i komunës është duke u paguar për shpenzimin e rrymës për dy njehsorët privat, e kanë verifikuar dhe vërtetuar se ata njësor janë të regjistruar në emër të G. G. dhe N. H., si dhe ky fakt është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve G. G. dhe N. H., të cilët e kanë pranuar që këta njehsor elektrik kanë qenë të regjistruar në emrin e tyre, mirëpo që të dy kanë pohuar që asnjëherë nuk kanë paguar për energjinë elektrike të shpenzuar, andaj bazuar në provat e lartë cekura gjykata ka konstatuar që i akuzuari si zyrtar për paga dhe pagesa, e ka dëmtuar buxhetin e komunës duke paguar me para të buxhetit të komunës për rrymën e shpenzuar në këta dy njehsor elektrik dhe me këto veprime ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPRK-së.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin dhe llojit të tij, Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me nenin 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale në mënyrën, kohën dhe vendin si në dispozitiv të aktgjykimit nuk ka gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, ndërsa si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë parasysh sjelljen korrekte gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjendjen shëndetësore, jo dënueshmerinë e tij të mëparshme e të cilat rrethana kanë ndikuar që të akuzuarit H. H. ti shqiptohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak në kohëzgjatje prej 1 (një) muaj dhe atë nga data 24.09.2014 e deri me datë 23.10.2014, me bindjen e plotë se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e të akuzuarit dhe se Gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së.

Vendimi që i akuzuari të detyrohet që të dëmtuarës Komuna në Rahovec të ja kompensoi dëmin e shkaktuar në shumën prej 2.371,90 €, është marrë bazuar në nenin 463 par. 1 dhe 2 të KPP-së, pasi nga ekspertiza e ekspertit financiar është konstatuar saktësisht se kjo

është saktësisht lartësia e dëmit që i akuzuari ja ka shkaktuar të dëmtuarës me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2, nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së dhe atë shpenzimet procedurës penale në shumën prej 163,52 €, ku përfshihen shpenzimet për ekspertizë financiare në shumën prej 122,64 € dhe plotësimin e ekspertizës financiare në shumën prej 40,88 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 100,00 €.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË**  
**PKR. nr. 47/15 datë 04.10.2016**

**Sekretarja Juridike**  
**Mandushe Doli**

**Kryetari i Trupit Gjykes-gjyqtari,**  
**Nikollë Komani**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.